

Fjalim i deputetit Fatmir Mediu

26.01.2023

Të nderuar deputetë të Knesetit, mirë se erdhët në Kuvendin e Shqipërisë!

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik, Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një ditë e veçantë dhimbjeje, por edhe reflektimi. “Kush harron të kaluarën është i destinuar ta përsërisë atë”, kjo është një thënie e mençur, që duhet ta bëjë gjithsecilin nga ne të reflektojë. Vërtet Holokausti ndoshta është një ditë e largët, por në analizën tonë shohim se herë pas here ato që u zhvilluan në atë kohë ngrenë kokë me qenie të tjera njerëzore dhe politike, të cilat, pa dyshim, kanë konsekuencat e veta. Dita e Holokaustit është dita e përkujtimit, që duhet të na bëjë të mendojmë se ku na çoi çmenduria e regjimit nazist. Kjo jo vetëm për ato që i shkaktoi popullit hebre, por për një dhimbje mbarënjëzore të torturave çnjerëzore të këtij regjimi, duke vazhduar edhe me regjimin komunist, i cili vrau 90 milionë njerëz të pafajshëm, persekutoi ndërmjet tyre po ashtu edhe hebre.

Të dashur deputetë të Knesetit, kam lexuar me vëmendje shumë të madhe Natan Sharanskin, që, gjithashtu, ka qenë deputet në Kneset, i cili frymëzoi liderët botërorë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për vlerat që ka demokracia dhe luftën që duhet të bëjmë ne të gjithë bashkë për të ndërtuar sisteme demokratike, të cilat në bazën e tyre kanë vlerësimin e jetëve njerëzore dhe respektimin e lirive dhe të drejtave.

Me popullin hebre ne kemi një histori që na bën krenarë. Është historia e vlerave më të mira shqiptare, e traditës sonë më të mirë, ku mund të përmendim raste pa fund. Unë dua të përmend rastin e familjes Ndrejoni, anëtarët e së cilës ishin antinazistë, antifashistë dhe mbështetën e strehuan popullin hebre, por u persekutuan nga regjimi komunist, duke mos iu shmangur dot kalvarit të vuajtjeve për të bërë atë që ishte më e mira në respekt të vlerës dhe të traditës shqiptare. Vlera e besës në traditën shqiptare duhet të na bëjë krenarë dhe të përgjegjshëm për atë që bëjmë sot. Nuk ka gjë më të mirë sesa të zhvillojmë marrëdhënie të mira me parlamentin e Izraelit, me Knesetin. Sot njohim një nivel tjetër marrëdhëniesh ndërmjet qeverive, gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme, por duhet të

njohim edhe një nivel shkëmbimesh parlamentare shumë herë më intensive, për çështje të cilat janë preokupimi ynë i përbashkët.

Unë, po ashtu, dua ta falënderoj qeverinë e Izraelit dhe të gjithë ata që ndihmuan në përballimin e sulmeve kibernetike nga Irani!

Irani nuk është problem vetëm për Izraelin, nuk është problem vetëm për Shqipërinë, por, Irani, Rusia dhe Kina janë problem për mbarë njerëzimin.

Duket qartë se bota sot po shkon në disa drejtime të tjera dhe nuk është thjesht bota e ëndrrave demokratike, por është edhe ëndrra e regjimeve diktatoriale, të cilat nuk njohin limite në veprimet e tyre, ashtu siç po bën Rusia në Ukrainë dhe ashtu siç po tentohet të bëhet në Ballkan. Ne, si shqiptarë, duhet të jemi të vëmendshëm për të bërë analizën tonë të përgjegjshme dhe për të marrë masat e duhura që rajoni i Ballkanit të mos kthehet në një rajon tjetër konflikti dhe dhimbjeje, e cila u përjetua shumë keq, njësoj me përmasat e ngjarjeve të tmerrshme të viteve '90.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk dua të zgjatem në histori, por le të jetë ky një moment reflektimi për gjithsecilin nga ne si qenie njerëzore, në radhë të parë, për atë që është vlerë, për atë që është e mirë: respektimi i jetës; pastaj ne, si politikanë, të bashkëpunojmë me njeri-tjetrin për t'i dhënë vlerë dhe shpresë jetës së qytetarëve shqiptarë, sepse prandaj jemi zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë.

Edhe një herë, faleminderit për prezencën dhe le të mbetet kjo ditë dhimbjeje si një ditë reflektimi për të na bërë më të mirë, më të vlefshëm dhe më njerëzorë!

Faleminderit!